



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Data: 21.07.20 Ref.: 979/200

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 82-të, të mbajtur më 25.06.2020, mori:

**V E N D I M**

- I. Nuk riakreditohet Kolegji “Biznesi” në nivel institucional.
- II. Ndalohej regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit me akreditim valid të Kolegjit Biznesi për vitin akademik 2020 – 2021 deri në periudhën e riakreditimit të dytë institucional.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

**Arsyetimi**

I. Kolegji “Biznesi” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional. AKA ka organizuar vlerësimin me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin “Biznesi”, me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional. Vlerësimi për riakreditim institucional është realizuar më 03.06.2020 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Milan Pol, Janez Vogrinc dhe Ketii Tsotniashvili.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) në mbledhjen e mbajtur më 25.06.2020 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit “Biznesi” dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vlerësimit, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se Kolegji “Biznesi” përmbush vetëm pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në



Manualin e Akreditimit. Nga gjithsejtë njëmbëdhjetë (11) kapitujt e standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, ekspertët kanë konstatuar se Kolegji “Biznesi” i plotëson substancialisht një (1) kapitull (Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit), pjesërisht gjashtë kapituj (6) (Misioni publik dhe objektivat institucionale; Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi; Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike; Mësimdhënia dhe të nxëniti; Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse; Burimet dhe hapësirat), ndërsa nuk plotëson katër kapituj (4) (Menaxhimi i cilësisë; Hulumtimi; Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional; Bashkëpunimi institucional).

Sa i përket kapitullit “Misioni publik dhe objektivat institucionale”, ekipi i ekspertëve ka konstatuar se Kolegji Biznesi ka një deklaratë të misionit relativisht të gjatë. Nga dokumentet e prezantuara nga kolegji dhe nga informatat e marra nga intervistat ekspertët ndërkombëtar të akreditimit kanë deklaruar se nuk ishte aspak e qartë se si është zhvilluar procesi për hartimin e deklaratës së misionit dhe nëse në këtë proces ishin përfshirë akterë relevant të brendshëm dhe të jashtëm. Në të njëjtën kohë është e qartë se çfarë ka ndërmarrë kolegji Biznesi për të siguruar se deklarata e misionit njihet dhe pranohet nga pjesëtarët e komunitetit akademik të Kolegjit. Në këtë kontekst ekspertët kanë shprehur dyshimin e tyre se si misioni aktual i Kolegjit Biznesi mund të shërbejë si udhëzues për planifikim strategjik, vendimmarrje dhe zhvillim të aktiviteteve në kuadër të Kolegjit.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi”, ekipi i ekspertëve ka deklaruar se sa i përket planifikimit strategjik, në RVV dhe në shtojcat e prezantuara nga Kolegji Biznesi, janë dhënë vetëm disa informata përmbledhëse. Aty thuhet se Kolegji ka një plan strategjik për periudhën 2020-2024. Sipas ekspertëve të akreditimit, një analizë më e thukët e planit të zbatimit të strategjisë tregon se përqendrimi i Kolegjit është kryesisht në procese të mësimdhënies dhe deri diku në marrëdhëniet e Kolegjit me palët e jashtme, duke lënë pa përfshirë komponentin e hulumtimit dhe fusha tjera të rëndësishme. Për më tepër, nuk është e qartë se si këto plane janë të integruara me proceset e buxhetimit vjetor dhe afatgjatë.

Në kuadër të këtij kapitulli të standardeve ekspertët e akreditimit kanë shtuar se Kolegji Biznesi nuk ka të zhvilluara mekanizmat për monitorim të caqeve afatshkurta dhe afatmesme dhe se nuk është e qartë se si kolegji e bën vlerësimin e rezultateve.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike”, ekspertët kanë konstatuar se Kolegji Biznesi ka Kodin e Etikës i cili përcakton vlerat e lirisë akademike, autonomisë institucionale dhe integritetit etik. Megjithatë, ekipi i ekspertëve të akreditimit ka vërejtur se jo të gjitha politikat e kolegjit janë në linjë me kodin e etikës dhe se ky kod jo gjithmonë zbatohet, duke ofruar shembuj të publikimeve në revista të dyshimta që janë të cilësuar si *predatory journals*. Po ashtu ekspertët vënë në pah mungesën e softuerit kundër plagjiaturës, dhe faktin se Kolegji Biznesi e adreson këtë çështje vetëm me anë të nënshkrimit të një deklaratë të ndershmërisë nga studentët dhe stafi akademik, gjë që nga ekipi i ekspertëve nuk konsiderohet si praktikë e mjaftueshme.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Menaxhimi i cilësisë”, ekspertët kanë vërejtur se aktivitetet e zyrës për sigurimin e cilësisë të Kolegjit Biznesi fokusohen kryesisht në vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit dhe rregullorja përkatëse nuk përcakton ndonjë njësi që ka përgjegjësi për vlerësimin e cilësisë së aktiviteteve të tjera të institucionit (p.sh. infrastruktura, shërbimet, monitorimin e planit strategjik etj.).



Rregullorja për sigurimin e cilësisë përshkruan procedurën për përgatitje për akreditim institucional dhe të programeve, mirëpo ekspertët kanë gjetur se ajo nuk përfshinë mekanizma, instrumente dhe procedura për vlerësim dhe përmirësim të brendshëm të cilësisë. Ekipi i ekspertëve të akreditimit ka konstatuar se Kolegji Biznesi kryen anketa me studentë me pyetje që kryesisht kanë për qëllim vlerësimin e profesorëve. Kolegji nuk kryen anketa me stafin apo me të diplomuarit. Pra sipas ekspertëve kolegji Biznesi nuk përfshinë të gjitha palët e interesit në procesin e sigurimit të cilësisë, këto procese nuk mbulojnë të gjitha aktivitetet e institucionit dhe aktivitetet për sigurimin e cilësisë nuk janë të integruara në proceset e planifikimit dhe të zhvillimit strategjik. Për më tepër, ekipi i ekspertëve të akreditimit ka gjetur se Kolegji Biznesi nuk ka një mekanizëm për rishikimin e sistemit ekzistues të sigurimit të cilësisë dhe për zbatimin e përmirësimeve të nevojshme.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Mësimdhënia dhe të nxënit” ekspertët janë shprehur se Kolegji Biznesi ka të përshkruara procedurat për zhvillimin dhe miratimin e programeve të studimit në rregulloren e brendshme, në statut dhe në rregulloren për sigurimin e cilësisë. Megjithatë, këto procedura nuk e saktësojnë se kush duhet të përfshihet në zhvillimin e programeve të studimit as mënyrën e inkorporimit të kërkesave të tregut të punës në procesin e zhvillimit të programeve. Përveç kësaj, ekspertët kanë gjetur se fusha të caktuara që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe monitorimin e programeve të studimit nuk janë konsistente në rregullore të ndryshme, dhe kjo gjithë shkakton huti në atë se cila procedurë duhet të ndiqet në praktikë. Si shembull ekspertët kanë përmendur faktin se rregullorja për sigurimin e cilësisë thotë se Komisioni për Sigurimin e Cilësisë duhet të vlerësojë programin e ri para se ai të dorëzohet në Këshillit të Lartë për Mësim dhe Shkencë, përderisa ky hap nuk përmendet fare në Rregulloren e brendshme dhe Statut. Ekipi i ekspertëve në raportin e vlerësimit ofron edhe një varg shembujsh të ngjashëm që ilustronë diskrepancën mes rregulloreve të përmendura. Në kuadër të këtij kapitulli të standardeve, ekipi i ekspertëve ka përmendur se Kolegji Biznesi nuk ka të definuar treguesit e cilësisë dhe për këtë arsye ekspertët nuk kanë arritur të gjejnë shembuj ku programet e studimit të kolegjit janë rishikuar dhe ndryshuar në bazë të vlerësimit të cilësisë së tyre.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Hulumtimi”, në raportin e vlerësimit ekipi i ekspertëve ka potencuar se Kolegji Biznesi nuk ka një plan për zhvillim të hulumtimit, si dhe në raportin e vet-vlerësimit dhe në rregulloret e brendshme të kolegjit nuk ka tregues të qartë për zhvillim të komponentit të hulumtimit. Në këtë kontekst ekipi i ekspertëve të akreditimit kanë konstatuar gjithashtu se stafi akademik i kolegjit publikon nën emrin e Kolegjit Biznesi. Nuk ka asnjë referencë sa i përket udhëzimeve për pronësinë intelektuale dhe procedurave për komercializimin e ideve të zhvilluara nga stafi dhe studentët. Pra nuk ekzistojnë politika, procedura të qarta dhe njësi organizative përkatëse që sigurojnë respektimin e parimeve etike në punë kërkimore.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional”, ekipi i ekspertëve ka deklaruar se Kolegji Biznesi nuk ka të zhvilluar një manual për punësim i cili do të ishte i qasshëm për të gjithë mësimdhënësit dhe stafin administrativ. Ekspertët po ashtu kanë konstatuar se ka mungesë të informatave lidhur me mbikëqyrjen, vlerësimin e performancës, avancimin, proceset mbështetëse dhe zhvillimin profesional.

Raporti ë mes të mësimdhënësve me orar të plotë dhe studentëve sipas ekspertëve është e pamundur të vlerësohet pasi që të dhënat e ofruara nga institucioni janë të ndryshme. Gjatë intervistës me



menaxhmentin e institucionit ekspertëve u është thënë se 20 staf akademik të rregullt janë të punësuar në kolegji, përderisa në dokumentet shtesë të dorëzuara pas intervistës del se numri i stafit akademik të rregullt është 36. Ekipi i ekspertëve gjithashtu nuk ka arritur të marr informata në lidhje me atë se çfarë ndodh nëse performanca e një mësimdhënësi vlerësohet të jetë jo e kënaqshëm. Aktualisht, Kolegji Biznesi nuk ka një plan të qartë për zhvillimin profesional të stafit, nuk ka një qaje të strukturuar për identifikimin e nevojave për zhvillim profesional dhe nuk ndanë resurse të mjaftueshme për këtë gjë.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse”, mes tjerash ekspertët kanë gjetur se, megjithëse sipas RVV-së kolegji ofron bursa për studentët e dalluar, mungojnë kriteret e përcaktuara për të qenë student i dalluar. Po ashtu gjatë takimit me studentë ekspertët kanë kuptuar se studentët nuk kanë njohuri për kriteret apo procedurat për të aplikuar për bursë. Kolegji biznesi ka një zhvilluar një doracak i cili ofron informata bazike lidhur me programet e studimit, stafin dhe njësitë organizative të kolegjit, mirëpo ky doracak nuk përfshinë informata për kushtet e regjistrimit, progresionin, njohjen e diplomave, politikat dhe procedurat që aplikohen në kolegji, të drejtat dhe përgjegjësitë e studentit apo për masat disiplinore. Për më tepër doracaku nuk është i publikuar në uebfaqe të institucionit.

Pos kësaj, ekspertët kanë konstatuar se kolegji Biznesi nuk ka mekanizma për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave lidhur me progresionin e studentëve, si dhe nuk ka mekanizma për të identifikuar studentët që kanë vështirësi në mësim dhe për të ofruar përkrahjen e nevojshme.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Burimet dhe hapësirat”, ekspertët kanë konstatuar se institucioni nuk posedon kushte adekuate sa i përket hapësirave dhe materialeve mësimore për të akomoduar studentët dhe stafin me nevoja të veçanta. Gjatë intervistës me menaxhmentin e kolegjit, ekspertëve u është thënë se studentët me nevoja të veçanta zakonisht regjistrohen në institucione publike.

Ekipi i ekspertëve nuk ka arritur të sigurojë fakte të mjaftueshme se si institucioni merr komente kthyes nga shfrytëzuesit lidhur me përshtatshmërinë e hapësirave dhe si ato komente merren parasysh dhe inkorporohen në proceset e sigurimit të cilësisë.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Bashkëpunimi institucional”, ekspertët e akreditimit kanë potencuar në raportin e vlerësimit se kolegji Biznesi nuk ka një strategji për internacionalizim e cila do të orientonte vendimmarrjen dhe alokimin e resurseve në këtë fushë. Kolegji Biznesi nuk ka të emëruar një anëtarë të menaxhmentit i cili/e cila do të kishte mandat për ndërmarrjen e iniciativave për bashkëpunim institucional. Në tri vitet e fundit Kolegji ka organizuar një konferencë shkencore, por dokumentacioni i prezantuar nuk ka arritur të bindë ekipin e ekspertëve se kjo konferencë kishte karakter ndërkombëtar. Menaxhmenti i kolegjit, gjatë intervistës, shpjegoi se Kolegji Biznesi nganjëherë ka studentë nga jashtë vendit por kryesisht nga shtetet fqinjë, dhe se ata duhet të ndjekin ligjëratat në gjuhën shqipe pasi që institucioni nuk ofron programe në gjuhën angleze. Gjatë intervistës me studentë ekipi i ekspertëve të akreditimit kuptoi se shumë rrallë ndodhë që të vijnë ligjërues nga jashtë, dhe kur kjo ndodhë, zakonisht ata vijnë nga Shqipëria apo nga Maqedonia e Veriut dhe mbajnë ligjëratat në gjuhën shqipe. Pos kësaj, ekspertët kanë konstatuar se angazhimi në bashkëpunime ndërkombëtare dhe kontributi në komunitet nuk janë pjesë e kriterëve për avancim apo vlerësim të performancës së stafit.

Prandaj, duke u bazuar në gjetjet e ekspertëve të akreditimit si dhe në rekomandimin final të tyre për mos akreditimin e Kolegjit Biznesi, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

  
Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësise



Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit "Biznesi"
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.